



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-16-0049

Ankuesit/Paditësit

1. N.L.

2. I.L. të dy të përfaqësuar nga avokati.

Kundër:

Të paditurit

1. Komuna, përfaqësuar nga F.K.

2. KB "M" Shtërpce, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, Rr. Agim Ramadani 23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-11-0097 të datës 25/02/2016, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësve refuzohet si e pabazuar,

2. Vërtetohet, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-11-0097 të datës 25/02/2016.

3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe rrjedha procedurale

Më 15 mars 2011, paditësit kanë parashtruar një padi kundër të paditurve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme Çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Dhoma e Posaçme) me të cilën kanë kërkuar që t'iu njihet e drejta ligjore se ata janë bashkë-pronarë të pronës së patundshme, të regjistruar si ngastër kadastrale nr. 124 në një sipërfaqe prej 2.3204 ha, që ndodhet në vendin e quajtur "C.M.", fleta poseduese nr. 106, zona kadastrale Soponicë, Komuna . Sipas pohimeve të paditësve, ata janë pasardhës të ndjerit B.L. , i cila ka qenë pronar ligjor i pronës së kërkuar deri në vitin 1962. Në vitin 1962 autoritetet shtetërore pa asnjë bazë ligjore e transferojnë këtë pronë fillimisht tek KB "R" në Kaçanik.

B.L. deri në vitin 1966 ishte i regjistruar si pronar i pronës së patundshme të regjistruar si ngastër kadastrale nr. 124 më një sipërfaqe prej 2.3204 ha, që ndodhet në vendin e quajtur "C.M.", zona kadastrale Soponicë.

Me vendimin nr. 1033 të datës 25 prill 1962, Këshilli Popullor i Komunës së mori pasurinë e patundshme të përmendur nga B.L. pasi që ishte konstatuar se ai e kishte uzurpuar këtë pronë pa ndonjë titull të duhur ligjore për B.L. ka ndërruar jetë më 23 shkurt 1992,çertifikata e vdekjes. Sipas vendimit mbi trashëgiminë të datës 8 gusht 2014, trashëgimtarët e tij ligjor janë N.L. dhe I.L.

Sipas fletës poseduese të pjesshme nr. 9432/2010 të datës 30 nëntor 2010, pasuria e patundshme e pretenduar aktualisht është e regjistruar në emrin e NSH "SH" në Shtërpce.

Paditësi padisë ia ka bashkangjitur provat si në vijim: Ekstraktin e fletës poseduese të lëshuar nga Komuna datë 30.11.2011, vendimin nr. 1033 të datës 25.04.1962 të Këshillit Popullor të Komunës së , Vendimin mbi trashëgiminë, fletën poseduese nr. 9432/2010 dt. 30.11.2010.

AKP-ja ka propozuar që padia të refuzohet si e pabazuar. Së pari, ajo e ka kontestuar faktin se paditësit janë pasardhës ligjor të paraardhësit të tyre, pasi që ata nuk kanë ofruar ndonjë vendim mbi trashëgiminë. Së dyti, AKP-ja vuri në dukje se paditësit nuk arritën të paraqesin bazën ligjore të kërkesës. Së treti, Vendimi nr. 1033 i datës 25 prill 1962 nuk u kundërshtua nga B.L. si dhe asnjë veprim tjetër nuk ishte ndërmarrë për ta shfuqizuar atë. Së fundi, AKP-ja i referohet nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar, i cili përcakton afatin kohor për kthimin e pasurive të patundshme të transferuar tek NSH-të.

Paditësi i parë N.L. ka ndërruar jetë më 16 tetor 2014. Trashëgimtari i tij i vetëm A.L. ka mbetur pranë padinë së tij.

Në seancën dëgjimore palët kryesisht pranuan deklaratat dhe qëndrimet e tyre. Ndërsa përfaqësuesi i paditësve pohoi se paditësit pronën kontestuese e kanë pasur në posedim dhe vazhdojnë ta kenë në posedim të pa penguar nga askush.

Më 25/02/2016 Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me, Aktgjykim, SCC-11-0097, refuzoi padinë e paditësve si të pa bazuar me arsyetim se paditësit nuk kanë provuar se paraardhësi i tyre ishte pronar i ligjshëm i pronës kontestuese përkundër faktit se ai posedon fletën poseduese nr. 132 e cila tregon se deri në vitin 1966 ai ishte pronar i pronës. Gjithashtu, Kolegji i Specializuar ka vlerësuar se bazuar në vendimin e mëvonshmen nr. 1033 i datës 25/04/1962 ai ishte shpallur uzurpator prandaj nuk ishte pronar i ligjshëm edhe pse i njëjti e kishte në posedim pronën në fjalë. I njëjti me asnjë provë nuk ka provuar se ka kundërshtuar vendimin e cekur më lartë. Prandaj padia ishte refuzuar si e pa bazuar.

Më 11/03/2016 paditësit (më tutje ankuesit), parashtuan ankesë kundër Aktgjykimit SCC-11-0097 të datës 25/02/2016 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, shkeljeve absolute dhe relative, nenit 8, arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me faktet, nenit 182 paragrafi 2. Në seancën dëgjimore ka qenë prezent vetëm një gjyqtarë, në këtë mënyrë me këtë Aktgjykim Kolegji i Specializuar ka shkelur edhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut për një gjykim të drejtë të pa anshëm, të pa varur dhe të arsyetuar, si dhe për shkak të përcaktimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Sipas tyre Gjykata nuk ka dhënë arsyet e duhura për faktet vendimtare, bazën ligjore të cilat mangësi e bëjnë Aktgjykimin të paqëndrueshëm. Ata më tej deklaruan se këtë pronë e kanë në posedim të pa penguar që nga vitit 1962 deri më sot dhe sipas nenit 29 të Ligjit mbi të drejtat sendore e drejta e pronësisë mund të fitohet edhe me mbajtje si dhe nenit 28 posedim i ligjshëm dhe me mirëbesim të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore juridike.

Ankuesit i kanë propozuar Kolegjit të Apelit që të aprovojë ankesën si të bazuar të prishë aktgjykimin e ankimuar dhe të kthejë çështjen për rivendosje Gjykatës së shkallës së parë.

Më 12 gusht 2016, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka paraqitur përgjigje në ankesë ku në tërësi kundërshton pretendimet e Ankuesve dhe e konsideron Aktgjykimin e kundërshtuar si të drejtë dhe ligjërish të bazuar. Sipas AKP-së fitimi i pronësisë mbi bazën e posedimit të pa penguar sipas neni 29 i Ligjit mbi MTHPJ nuk është i zbatueshëm në rastet kur kemi të bëjmë me pronë shoqërore. AKP-ja i ka propozuar Kolegjit të Apelit që të refuzojë ankesën si të pabazuar dhe të vërtetojë aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit Nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Shtojcës), Kolegji i Apelit ka vendosur që të mos vazhdojë me pjesën gojore të procedurës gjyqësore.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në pretendimet ankimore, Aktgjykimin e ankimuar dhe provat nga shkresat e lëndës gjënë se ankesa është e pabazuar, ndërsa Aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit ka vërejtur se pretendimet ankimore të paditësve lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 dhe

nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, që ka bërë, Kolegji i Specializuar duke mbajtur Seancën dëgjimore nga një gjyqtar i vetëm ndërsa Aktgjykimi i ankimuar është nënshkruar nga Kolegji në përbërje të plotë, janë të pa baza. Sipas nenit 9 të ligjit nr.04/L-033 dhe nenit 11 të Shtojcës së këtij Ligjit, Kolegji i Specializuar nëpërmjet urdhrit mundet që njërit prej anëtarëve të Kolegjit t'i delegoj përgjegjësit dhe autoritetin për të mbajtur një pjesë apo , procedurën e plote për një rast të caktuar. Me datën 23/11/2015, Kryesuesi i Kolegjit ka lëshua një urdhër me të cilin, mbajtja e një seance dëgjimore i është deleguar një gjyqtari të vetëm ndërsa nxjerrja e çdo Aktvendimi apo Aktgjykimi mbetet në përgjegjësin e Kolegjit në përbërje të plotë. Lidhur me lëshimin e këtij urdhri nga gjyqtari përgjegjës palët janë informuar në seancën dëgjimore të datës 15/01/2016. Të njëjtit nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim.

Paditësit në padinë e tyre kërkojnë që Dhoma e Posaçme të konfirmoj se ata janë bashkëpronarë të ngastrës kadastrale nr. 124 në sipërfaqe prej 2.32,04 ha, që ndodhet në vendin e quajtur "C.M.", fleta poseduese nr. 106, zona kadastrale, Soponicë, mbi bazën se nga paraardhësit i tyre është marrë pa bazë ligjore apo mbi bazën e parashkrimit fitues si posedues të pa trazuar që nga viti 1962 dhe të obligojë të paditurat që ta njohin të drejtën e pronësisë dhe të lejojnë që ta regjistrohet kjo tokë në emrin e tyre në regjistrat kadastral.

Pavarësisht se çfarë pozicioni juridik mund të ketë pasur babai i paditësve ndonjëherë në lidhje me tokën e kontestuar deri më 1962, pronësia e tij ishte mohuar me Vendimin e Këshillit Popullor të Komunës së , nr. 1033 të datës 25.04.1962. Ky vendim ishte bërë i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm për palët. Nuk ka prova se ai ishte kontestuar brenda afatit të dhënë kohor prej 15 ditëve pas pranimit të vendimit. Prandaj nuk ka bazë ligjore për Dhomën e Posaçme që ta shfuqizoj apo ndryshoj këtë vendim.

Për më tepër, në pajtim me Ligjin mbi Punën e Bashkuar, saktësisht neni 268, në rast se një pronë është marrë në mënyrë të paligjshme nga pronari i saj, nga ana e NSH-së, afati ligjor për ndërmarrjen e veprimeve ligjore për kthimin e tokës është (5) pesë vjet nga momenti që paditësi ka qenë i njoftuar për këtë veprim, respektivisht (10) dhjetë vjet nga momenti kur NSH-ja ka marrë në pronësi

pronën. Padia ishte parashtruar më 17/03/2011, ndërsa ishte pretenduar se prona ishte marr më 1962. Kohë e gjatë ka kaluar nga momenti i marrjes së pronës e deri tek momenti kur ishte parashtruar padia. Për pasojë, paditësi ka humbur të drejtën të kërkoj njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë në fjalë.

Gjykata vë në dukje se mbrojtja e Pronës siç është përcaktuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhet vetëm me ndonjë pronë ekzistuese të një personi. Prandaj, të shpresuarit se e drejta pasurore e shuar për një kohë të gjatë mund të rikthehet, nuk mund të konsiderohet si " posedim", e as ndonjë padi e kushtëzuar jashtë afatit ligjor si rezultat i mos përmbushjes së kushteve (shih Gratzinger dhe Gratzingerova v. Republika Çeke (dec.) [GC], nr. 39794/98, § 69, ECHR 2002-VII)

Në bazë të gjitha argumenteve të paraqitura dhe deklaratave të palëve në lëndën në fjalë, Gjykata erdhi në përfundim se fakt i rëndësishëm mbetet se toka ishte e regjistruar në emër të paditurës qysh nga viti 1962 nga autoriteti shtetëror. Që nga atëherë paluajtshmëria ishte pronë shoqërore.

Paditësit nuk e kishin fituar pronësinë të tokës së kontestuar me parashkrim fitues. Në kohën para ndryshimit të Ligjit mbi të Drejtat Themelore Pronësore në vitin 1996, e drejta e pronësisë mbi pronën shoqërore nuk mund të fitohej me parashkrim fitues (shih nenin 29 të Ligjit mbi të Drejtat Themelore Pronësore, Gazeta Zyrtare e RSFSJ nr 6/80.

Mundësia për fitimin e të drejtës së pronësisë është dhënë vetëm me ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike në vitin 1996, kur ishte shfuqizuar neni 29 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Juridiko Civile, me të cilin nen ishte sanksionuar pamundësia e fitimit të pronësisë mbi pronën shoqërore me parashkrim fitues.

Nga 1996 koha e kërkuar prej 20 viteve të posedimit të pandërprerë (neni 40.1 Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore) nuk ka kaluar ende.

Andaj Kolegji i Apelit pas shqyrtimit të çështjes, pretendimit mbi mënyrën e fitimit të pronësisë, mbi bazën e posedimit konstatoi se një mënyrë e tillë e fitimit të pronësisë nuk është në pajtim me kushtet dhe formën siç e kërkon ligji i zbatueshëm për fitimin e

pronësisë dhe gjithashtu edhe transferimi saj nuk saj nuk është në pajtim me Ligjin mbi qarkullimin e patundshmërive.

Prandaj Kolegji i Apelit i vlerëson si të sakta përfundimet, gjetjet faktike dhe arsyetimet ligjore të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar, andaj nuk mund ti pranon pohimet ankimore e paditësve se ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Duke bazuar në këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e të paditurës duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 25/02/2016 andaj nuk do të caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 19 shtator 2019

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues _____

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT:

Ju lutem dërgojeni këtë Aktgjykim tekë :

- Palët,

- Kolegjin e Specializuar i DHPGJS-së në lëndën SCC-11-0097

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
